



02Nr 9668 /2023

13.11.2023

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, neni 80 dhe 81 , Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125 neni 3 pika 1.20 dhe neni 69 pika 1.4 dhe pika 1.11, Udhëzimin Administrativ (MSH) Nr.04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor neni 15 pika 1.7 dhe 1.13, Udhëzimin Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Komuna Hani Elezit shpallë:

KONKURS

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni: **Komuna Hani Elezit**

Drejtoria: **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Titulli i vendit të punës: **Infermier/e**

njësia/ sektori: **Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Menduh Kaloshi” Hani i Elezit,**

Numri i pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar**

Titulli i mbikëqyrësit: **Drejtori i QKMF-së**

Koeficienti/Grada: **H-17 ose H-20**

Orët e punës: **40 orë në javë**

Detyrat dhe përgjegjësitë: Sipas Qarkores Informative 02/2017 e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë

- Siguron mbrojtje primare shëndetësore .
- Cakton, planifikon implementon dhe vlerëson kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar.
- Kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët .
- Të administron terapinë e përshkruar në përputhje me politikën institucionale.
- Tu ofron pacientëve informata të qarta lidhur me kujdesin i cili u ofrohet atyre.
- Të përdorë dhe mirëmban në mënyrë të sigurt të gjitha pajisjet .
- Të merr pjesë në mbledhjet e ekipit kur është e nevojshme.
- Të ruan konfidencialitetin e plotë për çështje që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit dhe punën e institucionit .
- Të kryen dhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë .

Dokumentet e nevojshme:

- Dëshminë për shkollimin e mbaruar në Infermieri (e vërtetuar).
- Licenca e Punës (e vërtetuar).
- Dokumentin e identifikimit.
- Certifikatën që nuk është nën Hetime (nga Gjykata).
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore (për arsye të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve kërkohet në fund të procedurës së rekrutimit vetëm nga kandidati më i suskeshëm)
- Certifikatën që dëshmon njohuri nga kompjuteri dhe njohuri tjera e dëshirueshme .
- Kualifikime tjera (Trajnime).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda 30 ditëve nga data **13.11.2023 deri 12.12.2023 (16:00)**.

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëpriten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.



Kryetari i Komunës
Mehmet Bakazhi